




**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA**

**KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE**



Datë: 14.05.2014

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 30.04.2014, pas shqyrtimit të propozimit të Nr. 242, të datës 18.04.2014, paraqitur nga Drejtoria për Financa, Buxhet dhe Pronë, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë dhe Financa, bazuar në nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (c), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 27, shkronja (ç) të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

1. Për aprovimin e buxhetit të shpenzuar në komunën e Fushë-Kosovës, për tre mujorin e parë të vitit 2014, në shumë të përgjithshme prej 1,127,705.58€.
2. Buxheti i shpenzuar nëpër njësitë buxhetore ekonomike është si vijon:
 - 2.1 Në Administratë buxheti i shpenzuar është 341,936.72€,
 - 2.2 Në Arsim buxheti i shpenzuar është 585,019.01€,
 - 2.3 Në Shëndetësi buxheti i shpenzuar është 195,711.16€ dhe
 - 2.4 Në Zyrën Komunale për Komunitete dhe Kthim buxheti i shpenzuar është 5,038.69€.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Financa, Buxhet dhe Pronë.
4. Ky vendim hyn në fuqi, ditën e aprovimit, nga Kuvendi i Komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit, Drejtorisë për FBP dhe Arkivës.


**Kryesues i Kuvendit të Komunës
Mr. Fadil Krasniqi**





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 14.05.2014

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 30.04.2014, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 248 të datës 22.04.2014, paraqitur nga Drejtoria për Arsim, bazuar në nenin 17, shkronja (h), nenin 40, pika 40.2, shkronja (c, l) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 6, nenin 7, nenin 19 të Ligjit për arsimin dhe aftësimin për të rritur Nr.04/L-143 (Gazeta Zyrtare 02/2013), nenin 12, pika 12.1 shkronja (ë), nenin 27, shkronja (ç, nj), të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet propozimi për hapjen e linjës buxhetore, në kategorinë ekonomike 11 për rroga dhe paga.
2. Mjetet financiare, në shumë të përgjithshme prej 18,060.00€, si të hyra vetiake në arsim, destinohen për pagesat e arsimtarëve që kanë zhvilluar dhe zhvillojnë procesin mësimor dhe mbajtjen e provimeve nga mësimi joformal dhe alokohen në kategorinë ekonomike 11 në arsimin e mesëm si vijon: në arsim të mesëm për Shkollën e Mesme 'Teknike Minatori', kodi i programit Nr. 94231, shuma prej 3,827.40€; në arsim të mesëm për Shkollën e Mesme 'Hoxhë Kadri Prishtina', kodi i programit Nr. 94232, shuma prej 8,658.18€ dhe në arsim të mesëm për Shkollën e Mesme 'Hivzi Sylejmani', kodi i programit Nr. 94233, shuma prej 5,574.42€.
3. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera është kompetencë e Drejtorisë për Financa, Buxhet e Pronë dhe Drejtorisë për Arsim.
4. Ky vendim hyn në fuqi, ditën e aprovimit nga Kuvendi i komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit, Drejtorisë për FBP, Drejtorisë për Arsim, dhe Arkivës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Mr. Fadil Krasniqi

